



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli i Ministrave**

**V E N D I M**

**Nr. 341 datë 8.4.2009**

**P Ë R**

**PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR LËSHIMIN E DOKUMENTAVE**  
**LIGJORË NGA AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË**  
**EKSPORTEVE, SUBJEKTEVE TË PËRFSHIRA NË TRANSFERIMET**  
**NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE USHTARAKE DHE MALLRAVE E**  
**TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË DYFISHTË**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 38, të Ligjit nr. 9707, datë 05.04.2007 "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së importi-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave,

**V E N D O S I:**

1. Caktimin e tarifave për lëshimin e dokumentave ligjorë, subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Caktimin e tarifave për lëshimin e dokumentave ligjorë, subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake, sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**



**SALI BERISHA**

MINISTRI I MBROJTJES

GAZMEND OKETA



## LIDHJA NR. 1

Tarifat për lëshimin e dokumentave ligjorë, subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë:

<u>Shërbimi</u>	<u>Tarifa në lekë</u>
1. Lëshim i çertifikatës ndërkombëtare të importit	100
2. Lëshim i çertifikatës së përdoruesit të fundit	100
3. Lëshim i çertifikatës së deklaratës doganore	100
4. Lëshim i çertifikatës së shpërndarjes	100
5. Lëshim i autorizimit për import, eksport të përkohshëm të mallrave	100
6. Lëshim i autorizimit për mallrat e destinuara për në shtetet që janë objekt i embargos	100
7. Lëshim i licensës me një përdorim (1 vit), për import, eksport, tranzit, transship dhe ndërmjetësim (brokerage)	3.000
8. Lëshim i licensës së përgjithshme (3 vjet), për import, eksport, tranzit, transship dhe ndërmjetësim (brokerage)	6.000
9. Lëshim i licensës së pakufizuar (3 vjet), për import, eksport, tranzit, transship dhe ndërmjetësim (brokerage)	6.000
10. Çrregjistrimi i subjekteve	100
11. Lëshim i dublikatës së çertifikatës së rregjistrimit apo licensës/autorizimit	100
12. Lëshim i ekstrakteve për një të dhënë të rregjistrimit	100
13. Lëshim i kopjeve të dokumentave të mësipërm	100
14. Çdo veprim tjetër i parashikuar nga ligji dhe i pa përmendur më sipër	100

## LIDHIA NR. 2


Tarifat për lëshimin e dokumentave ligjorë, subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave e teknologjive ushtarake:

<u>Shërbimi</u>	<u>Tarifa në lekë</u>
1. Lëshim i çertifikatës së rregjistrimit	3.000
2. Lëshim i çertifikatës ndërkombëtare të importit	100
3. Lëshim i çertifikatës së përdoruesit të fundit	100
4. Lëshim i çertifikatës së deklaratës doganore	100
5. Lëshim i çertifikatës së shpërndarjes	100
6. Lëshim i autorizimit për import, eksport të përkohshëm të mallrave	100
7. Lëshim i autorizimit për mallrat e destinuara për në shtetet që janë objekt i embargos	100
8. Lëshim i autorizimit për kryerjen e negociatave për nënshkrimin e një marrëveshje ekonomike të huaj/kontrate për mallrat ushtarake	100
9. Lëshim i licensës me një përdorim (1 vit), për import, eksport, tranzit, transship dhe ndërmjetësimin (brokerage)	6.000
10. Lëshim i licensës së përgjithshme (3 vjet) për import, eksport, tranzit, transship dhe ndërmjetësimin (brokerage)	10.000
11. Lëshim i licensës së pakufizuar, për import, eksport, tranzit, transship dhe ndërmjetësimin (brokerage)	10.000
12. Çrregjistrimi i subjekteve	100
13. Lëshim i dublikatës së çertifikatës së rregjistrimit apo licensës/autorizimit	100
14. Lëshim i ekstrakteve për një të dhënë të rregjistrimit	100
15. Lëshim i kopjeve të dokumentave të mësipërm	100
16. Çdo veprim tjetër i parashikuar nga ligji dhe i pa përmendur më sipër	100

NR.PROT.1170/1  
DATË 16.4.2009

PRESIDENCËS  
KUVENDIT  
MINISTRISË SË MBROJTJES  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
AUTORITETIT TË KONTROLLIT SHTETËROR  
TË EKSPORTEVE

Gjergj LEZHA  
Sekretari i Përgjithshëm



The stamp is circular and contains the text "REPUBLIKË E SHqipërisë" at the top, "MINISTRI I MBROJTJES" on the right, and "AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE" at the bottom. A handwritten signature is written over the stamp.